



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 481 Prot.

Tiranë, më datë 01.08.2025

VENDIM

Nr. 435, datë 01.08.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”*, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.08.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit të potencialit arkeologjik hartuar në kuadër të projektit *“Urban Millefeuille”*, me vendndodhje në rrugën *“Siri Kodra”*, Tiranë me zhvillues subjektet **“Glob 3X Group” sh.p.k. dhe “Artech Group” sh.p.k.**;
2. Gjatë procesit të zbatimit, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 145, pika 1 dhe nëse ndeshen gjetje rastësore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen sipas përcaktimeve të neneve 145 pika 2 - 147;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

